



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 92, datë 06.09.2022

**PËR**  
**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT TË PËRFITUAR NË**  
**ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 503, DATË 27.07.2022**  
**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E**  
**RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË DURRËS, VORË**  
**DHE SHIJAK”**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak”, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit në masën 72409932 (shtatëdhjetë e dy milionë e katërqind e nëntë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 503, datë 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak”, për t’u përdorur për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët



përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para sipas aktekspertizave të thelluara në bashkinë Durrës.

2. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Durrës, në masën 43445959 (dyzet e tre milion e ktërqind e dyzet e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas tabelës së mëposhtme:

VKM që ka miratuar fondin	Gr.	K a p	Progr ami	Llog. ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë në lekë	Financimi për 2022 në lekë
NR. 503, DATË 27.07.2022	00	1	04960	606	94902AC	Financimi i rindërtimit të banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para	72409932	43445959

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Shërbimeve Publike, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

## ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Zamira Mustafaraj



U shpall sot me datë 07.09.2022





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT Durrës**

Nr. 700/2 prot.

Durrës, më 13.09.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
Durrës**



**KRYETARIT TË BASHKISË  
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.92 datë 06.09.2022

Për miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit të përfituar në zbatim të VKM Nr 503 dt 27.07.2022 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkitë Durrës , Vorë dhe Shijak”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI  
EMILJAN JANI**

